



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:016377
Datë: 19.07.2022
Numri i dokumentit: 03241704

C.nr.109/21

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Durim Balaj dhe zyrtaren ligjore Albana Curri, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.K. nga Gj., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Agron Krasniqi, avokat në Prishtinë, me adresë FAH 117, kundër të paditurit SHSKUK në Gjakovë, rruga..., të cilën e përfaqëson V.R., me autorizim në shkresat e lëndës, për pagesën e pagave jubilarë, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor-publik, në të cilin morën pjesë të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, me 13 korrik 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.K. nga Gj. dhe DETYROHET i padituri SHSKUK në Gj., që paditësit në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës, t'ia paguaj shumën prej 659,00 euro (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 28.01.2021 (data e parashtrimit të padisë) e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 269,20 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro e njëzetë cent), e këtë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZOHET e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumën e gjykuar sikurse në pikën I të këtij aktgjykimi, dhe atë në shumën prej 1,044.04 (njëmijë e dyzet e katër euro e katër cent).

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij në këtë gjykatë, me datë 28.01.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurit të lartpërmendur, me objekt kompensimin e shpërblimit jubilar, duke theksuar se i njëjti është në marrëdhënie pune në SHSKUK në Gj., me kontratë të rregullt të punës dhe ka 13 vite përvojë pune, e cila vërtetohet nga vërtetimi i lëshuar nga institucioni ku punon. Ka theksuar se e drejta për të kërkuar kompensimin e pagës jubilarë derivon nga neni 17 paragrafi 3 i Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, e datës 11.06.2018.

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë së parashtruar në këtë gjykatë, duke kërkuar nga gjykata që t'a aprovoj padinë e paditësit në lartësi prej 1,703.04 euro –bruto, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë shumën prej 30,00 euro e cila referohet taksës gjyqësore të paguar për padi, shumën prej 104,00 euro e cila shumë i referohet përpilimit të padisë, si dhe shumën prej 135,20 euro për përfaqësim në seancën kryesore.

I padituri në përgjigje në padi të parashtruar në këtë gjykatë me datë 27.04.2021, ka theksuar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për arsye se i njëjti nuk është anëtar i Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, andaj bazuar në nenin 4 pika 3 të Kontratës Kolektive Sektoriale, përfitues të beneficioneve të cilat dalin nga kjo marrëveshje dhe të cilat bazohen në ligjin e punës janë të gjithë punëtorët shëndetësor, ndërsa beneficionet/dobitë që dalin nga marrëveshjet e që nuk janë pjesë e ligjit të punës, i gëzojnë vetëm anëtarët e FSSHK-së.

E autorizuar e të paditurit gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Njëkohësisht e ka kundërshtuar edhe lartësinë e vlerës së kontestit, në të cilën është përfshirë kujdestaria, shujta dhe shtesa emergjente për covid – 19, duke shtuar se edhe buxheti i vitit 2021, nuk ka paraparë vije buxhetore për pagesën e shpërblimeve jubilarë.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, gjykata bëri administrimin e provave, dhe atë: Kontratës së Punës, në kohë të pa caktuar, me nr. të prot. 734, datë 06.04.2018, e lidhur në mes të paditësit dhe këtu të paditurit; Listën e pagave e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për periudhën 01.11.2020 - 31.11.2020, si dhe Vërtetim nga marrëdhënia e punës, i lëshuar nga SHSKUK në Gjakovë, datë 29.12.2020

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga provat e zbatuara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Me kontratën e punës me nr. të prot. 734, datë 06.04.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi, ka lidhur kontratë pune në kohë të pa caktuar me të paditurin SHSKUK në Gjakovë, me detyrat e punës: Mjek Specialist – Ortoped – Traumatolog në Repartin e Ortopedisë, me kohëzgjatje 06.04.2018 – 06.04.2021

Nga vërtetimi i marrëdhënies së punës, datë 14.05.2021, i lëshuar nga SHSKUK në Gjakovë është provuar rrethana se paditësi është e punësuar tek i padituri SHSKUK në Gjakovë, si Mjek Specialist – Ortoped – Traumatolog në Repartin e Ortopedisë prej datës 10.01.2011. Vërtetimi në fjalë lëshohet si dëshmi për stazhin e punës prej datës 10.01.2021 në QKMF – Institucione Shëndetësore.

Nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për periudhën 01.11.2020 - 31.11.2020, vërtetohet se paditësi ka 13 vite përvojë pune dhe realizon pagë bazë mujore në lartësi prej 659,00 euro.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësi është i punësuar tek i padituri për më shumë se 10 vite, e që prej kohës kur i ka mbushur 10 vite përvojë pune, nuk i është bërë pagesa për shpërblim jubilar në vlerë të një page mujore, të paraparë me nenin 17 par. 3 pika 3.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS). Mos pagesën e këtyre pagave e ka pohuar edhe i padituri përmes përgjigjes në padi si dhe gjatë shqyrtimit në këtë çështje kontestimore.

Gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadisë vendosi duke ju referuar Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, ku në nenin 17 paragrafi 3 pika 3.1, është paraparë se: *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë [...] Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit në vlerë të një page mujore të tij”*. Përvojën e punës së paditësit gjykata e vërtetojë nga vërtetimi i marrëdhënies së punës, datë 29.12.2020, i lëshuar nga SHSKUK, ndërsa lartësinë e pagës bazë mujore prej 659,00 euro, e vërtetojë nga lista e pagave, e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, andaj edhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke ia njohur shumën prej 659,00 euro.

Në anën tjetër, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar pjesërisht kërkesën e paditëses dhe shumën prej 1,044.04 euro, pasi që erdhi në përfundim së paga mujore bazë (pa shtesa) e paditësit është saktësisht 659,00 euro, bazuar në listën e pagave të administruar në këtë shqyrtim.

Gjykata vlerëson së paga mujore me shtesat tjera të paraqitura në listën e pagave dhe atë pagesa e shujtave, nuk mund të jenë objekt përfitimi nga paditësi, pasi që legjislacioni aktual i punës ka bërë dallimin e pagës dhe shtesave tjera në punë. Me nenin 55 paragrafi 2 i Ligjit të Punës, është paraparë se *“Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës”*. Pra përcaktimi ligjor nga ky nen, ndan atë çka nënkupton pagë dhe shtesa nga paga. Në anën tjetër, me nenin 17 paragrafi 3 pika 3.1 i Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, parashihet se i punësuar ka të drejtën e realizimit të një page mujore, e që nuk i përfshihen shtesat tjera nga paga.

Në nenin 17 paragrafi 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë parashihet se *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar, i njëjti është i legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga i padituri, së këndejmi, paditësi ka rolin e kreditorit kurse i padituri rolin e debitorit.

Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Rrjedhimisht, duke qenë se i padituri i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që t’u detyroj të paditurin që paditësit t’ia kompensoj shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimin e të autorizuarës së të paditurit lidhur me atë së paditësi nuk është anëtar i Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, mirëpo i njëjti ishte i pabazuar, ngase me 4 pika 3 të Kontratës Kolektive Sektoriale, parashihet se *“Përfitues të beneficioneve të cilat dalin nga kjo marrëveshje dhe të cilat bazohen në ligjin e punës janë të gjithë punëtorët shëndetësor, ndërsa beneficionet/dobitë që dalin nga marrëveshjet e që nuk janë pjesë e ligjit të punës, i gëzojnë vetëm anëtarët e FSSHK-së”*. Duke u nisur nga përcaktimi normativ i lartcekur, gjykata vlerëson së beneficionet e parapara me Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë i përfitojnë të gjithë të punësuarit në sistemin e shëndetësisë, pasi që kontrata kolektive është paraparë në Ligjin e Punës, dhe atë në nenin 90 të Ligjit të Punës, ndërsa sa i përket mungesës së linjës buxhetore, përkatësisht mjeteve financiare, në rastin konkret i padituri është dashur me kohë të planifikoj buxhetin për këto raste, e jo të thirret se nuk ka paraparë linjë buxhetore për këtë lloj të kompensimit, për çka në rastin konkret pretendimet e këtilla nuk patën influencë për të vendosur ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet procedurale e mori duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së, me ç’rast paditësit iu pranua shuma e përgjithshme e shpenzimeve në vlerë prej 269,20 euro. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 30,00 euro (sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104,00 euro, si dhe përfaqësim në një seancë gjyqësore 135.20 euro (e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës).

Nga sa u tha më lartë, në përputhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.109/21, me 13 korrik 2022

G J Y Q T A R I,
Durim Balaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.